

AKT NORMATIV
Nr. 7, datë 12.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN NORMATIV NR.1, DATË 10.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN, AUTORIZIMIN E PROCEDURËS PËR LEJIMIN E HYRJES DHE ADMINISTRIMIT TË VAKSINAVE ANTICOVID-19 NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, SI DHE PËRDORIMIN E TYRE NË POPULLATË”, MIRATUAR ME LIGJIN NR.2/2021

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Neni 2, i aktit normativ nr.1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anticovid-19 në Republikën e Shqipërisë , si dhe përdorimin e tyre në popullatë”, miratuar me ligjin nr.2/2021, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Aprovimi i përdorimit të vaksinës në popullatë

Vaksinat anticovid-19 aprovohen për përdorim në popullatë bazuar në aprovimet e *Food and Drugs Administration* të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (FDA), ose *European Medicine Agency* (EMA) të Bashkimit Evropian ose të trupave të tjera certifikuese të vendeve që prodhojnë vakcina anticovid-19.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama